



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1718/1 prot.

Tiranë, më 09.07.2025

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me projektvendimin *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave”*

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 3173/2 prot., datë 02.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1718 prot., datë 03.07.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave”* (në vijim, *“projektvendimi”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatohet se, krijimi i bazës së të dhënave shtetërore *“Regjistri për ekzekutimin dhe vjeljen e gjobave”*, (në vijim, *“Regjistri”*) do të administrohet nga Ministria e Financave.

Referuar pikës 3 të projektvendimit parashikohet se, regjistri do të përbëhet nga të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, të cilat kanë në përmbajtje edhe të dhëna personale, si dhe bazat e të dhënave të institucioneve të tjera me të cilët ky regjistër do të ndërveprojë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi i këtij regjistri me baza të të dhënave të palëve të treta me qëllim mbledhjen e gjobave të vendosura nga institucionet shtetërore, në mënyrë efikase dhe të sigurt, legjitimohet vetëm nëse është e parashikuar në ligjin specifik, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim, *“Ligji”*).

Duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, kategoritë e të dhënave që do të shkëmbehen midis regjistrave, duhet të identifikohen në mënyrë konkrete, duke u bazuar në parashikimet e legjislacioneve respektive nga autoritetet/institucionet përgjegjëse që administrojnë këto regjistra, si dhe në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave personale, të parashikuar në pikën 3 të nenit 6 të Ligjit, i cili përcakton se, të dhënat personale janë të përshtatshme e të

nevojshme për qëllimin e përpunimit dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

Gjithashtu, vërejmë se, në pikën 3/b/i të projektvendimit lidhur me të dhënat dytësore, nga ndërveprimi i Regjistrit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim, “*RKGJC*”), do të shkëmbehen, ndër të tjera, këto kategori të të dhënave personale, “*Vendlindja*”, “*Gjinia*”, “*Shtetësia*”, “*Kombësia*”.

Në vlerësim të Zyrës së Komisionerit, shkëmbimi/përpunimi i të dhënave dytësore të sipërpërmendura, është në kundërshtim me parimin e minimizimit të të dhënave personale.

Në vijim të sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron të rivlerësoni të gjithë të dhënat dytësore të parashikuara në **germën “b”, të pikës 3 të projektvendimit**, duke pëzgjedhur vetëm ato kategori të të dhënave personale, të mjaftueshme për realizimin e qëllimit dhe të ndërveprimit në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave.

Gjithashtu, lidhur me ndërveprimin e këtij Regjistri me RKGJC, Zyra e Komisionerit ju bën me dije se, Udhëzimi i përbashkët me nr. 463, datë 10.12.2020, i Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin*”, (në vijim, “*Udhëzimi*”), në pikën 1 të tij, përcakton se:

“Institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë) mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltar dhe nga aktet e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë ju njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin, përcaktohet në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi”.

Gjatë ndërveprimit, shkëmbimi i të dhënave personale midis regjistrave, mund të kryhet vetëm nëse një dispozitë ligjore konkrete e autorizon këtë ndërveprim, duke përcaktuar dhe kategoritë e të dhënave personale që do të shkëmbehen.

Nga verifikimi i përmbajtjes së Aneksit 1, të këtij Udhëzimi rezulton se, Ministria e Financës (në vijim, “*Ministria*”), në cilësinë e institucionit administrues të bazës së të dhënave të Regjistrit, nuk renditet në listën e institucioneve të cilat marrin informacion nga RKGJC. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit sugjeron se, Ministria duhet të marrë masa për përfshirjen e tij, në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi.

Njëkohësisht, sugjerojmë që **pika 4 e projektvendimit**, të formulohet, si më poshtë vijon:

“Regjistri për Ekzekutimin dhe Vjeljen e Gjobave, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet dhe ndërvepron me bazat e të dhënave, të institucioneve të përcaktuara në pikën 9 të projektvendimit.”

Më tej, sugjerojmë që **pika 6 e projektvendimit**, të riformulohet, me përmbajtje si vijon:

“Të dhënat e mbledhura nga regjistri mund të përdoren për analiza dhe vlerësime. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Së fundmi, bazuar në nenin 28 të Ligjit, Zyra e Komisionerit sugjeron që, në përmbajtje **të pikës 8 të projektvendimit**, të përfshihet një pikë me këtë përmbajtje:

“Për çdo veprim në regjistër lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, duhet të sigurohet gjurmueshmëria, me qëllim garantimin e konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit.”

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektvendim do të konsiderohet i hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi